

VENDIM
Nr. 100, datë 9.4.2026

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 mW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13 dhe 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 709/6 prot., datë 8.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw.

- Në vijim të këtij licencimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikimin e aneksit A të kësaj licence, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 10 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 76, datë 12.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.3.2026 dhe 14.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 23.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 709/3 prot., datë 18.3.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 709/4 prot., datë 18.3.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 709/5 prot., datë 24.3.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.

- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti